

SHTOJCA 2

Refuzim i vaksinës ndaj COVID-19

Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik kanë rekomanduar vaksinimin tim pranë _____, në mënyrë që të mbrohem unë dhe personat të cilëve unë i shërbej.

Pranoj që jam i/e ndërgjegjshëm për faktet e mëposhtëme:

- (1) COVID-19 është një sëmundje e rëndë respiratore që vret me mijëra njerëz në botë.

Jam i/e ndërgjegjshëm që faktet e mëposhtëme nuk janë të verifikuar shkencërisht:

- (2) Vaksinimi ndaj COVID-19 rekomandohet për mua dhe të gjithë personelin për të na mbrojtur ne dhe personat përreth nga infeksioni SARS-CoV-2, komplikacionet e sëmundjes dhe vdekja.

Nuk jam dakort që vaksina që mund të bëja unë, do të mbronte personat rreth meje sepse (sipas Doktor Anthony Fauci) personat e pavaksinuar kanë të njëjtën ngarkesë virale si personat e vaksinuar kur infektohen, dhe se vaksina nuk ndalon infektimin por vetëm rrit shanset e mia për mbijetesë në rast infektimi.

- (3) Nëse prekem nga COVID-19, unë mund ta përhap virusin përpara dhe pas shfaqjes së shenjave të tij. Virusi i përhapur prej meje mund të prekë të gjithë personat në institucionin ku unë shërbej.

Nuk jam dakort që unë mund të përhap virusin më shumë se një i vaksinuar sepse në asnjë literaturë shkencore nuk thuhet se personat e vaksinuar nuk infektohen njësoj me të pavaksinuarit. Si të vaksinuarit dhe të pavaksinuarit infektohen njëllor, ndryshimi është tek mënyra se si e përballon. Madje njerëzit e vaksinuar, mbase për shkak të përballimit më të mirë të infektimit, mund të mos e kuptojnë dhe mund të jenë më të pakujdeshëm se unë për ta përhapur.

- (4) Nëse prekem nga COVID-19, edhe pse vetë mund të mos kem simptoma apo ti kem ato në nivel mesatar, mund ta përhap virusin dhe të tjerët mund të sëmuren shumë rëndë.

Nuk jam dakort që unë mund të përhap virusin më shumë se një i vaksinuar sepse në asnjë literaturë shkencore nuk thuhet se personat e vaksinuar nuk infektohen njësoj me të pavaksinuarit. Si të vaksinuarit dhe të pavaksinuarit infektohen njëllor, ndryshimi është tek mënyra se si e përballon. Madje njerëzit e vaksinuar, mbase për shkak të përballimit më të mirë të infektimit, mund të mos e kuptojnë dhe mund të jenë më të pakujdeshëm se unë për ta përhapur.

- (5) E kuptoj që COVID-19 nuk merret nga vaksinimi me këtë vaksinë.
Unë këtë nuk e di.
- (6) Pasojat e refuzimit tim për tu vaksinuar ndaj COVID-19 mund të kenë efekte kërcënuese për shëndetin dhe jetën, për mua dhe personat me të cilët unë kam kontakt, përfshirë këtu:

- të gjithë personat në institucionin shëndetësor ku unë shërbej;
- bashkëpunëtorët e mi;
- familjarët e mi;
- komunitetin ku unë jetoj.
-

Nuk jam dakort që unë mund të përhap virusin më shumë se një i vaksinuar sepse në asnjë literaturë shkencore nuk thuhet se personat e vaksinuar nuk infektohen njësoj me të pavaksinuarit. Si të vaksinuarit dhe të pavaksinuarit infektohen njëllor, ndryshimi është tek mënyra se si e përballon. Madje njerëzit e vaksinuar, mbase për shkak të përballimit më të mirë të infektimit, mund të mos e kuptojnë dhe mund të jenë më të pakujdeshëm se unë për ta përhapur.

Përkundër këtyre fakteve, unë zgjedh të mos vaksinohem tani për arsyet e mëposhtme:

ARSYET SE PSE UNË NUK JAM GATI TË BËJ VAKSINËN ANTICOVID:

***Nuk jam aspak dakort me vërtetësinë e të gjithë pikave të mësipërme si të paverifikuara shkencërisht edhe për shkak të debatit midis ekspertëve të ndryshëm në botë dhe Shqipëri, dhe nuk jam gati të vaksinohem tani sepse:
Duke ju referuar 6 pikave të mësipërme deklaroj***

Arsyeja Ligjore nr 1.

Nuk kam info nëse kjo vaksinë është e regjistruar sipa ligjit.

Në Legjislacionin Shqiptar nuk lejohet regjistrimi i barnave me procedurë të përshpejtuar dhe nuk kam asnjë siguri që kjo vaksinë të ketë kaluar fazat ligjore të regjistrimit dhe këtë e argumentoj me vetë referencën e dhënë sipas "Planit Kombëtar të Vaksinimit AntiCovid", (i publikuar në media) në kapitullin "5. Procedurat Kombëtare Rregullatore dhe përmirësimi i tyre" ku përcaktohet se:

"Aktualisht procesi rregullator në lidhje me vaksinat mbeshtetet në ligjin për barnat dhe shërbimin farmaceutik N.105/2014 dhe ligjin për semundjet infektive 15/2016.

Në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë për barnat dhe për regjistrimin e barnave, nuk ka asnjë nen për të lejuar regjistrim të barit/barnave me procedurë të përshpejtuar, as për arsye pandemie dhe as për arsye të tjera. Aktualisht vendet e ndryshme nëpër botë deri tani kanë kryer regjistrimin me procedurë të përshpejtuar nga autoritete strikte rregullatore sipas një liste të OBSH. Kjo është një procedurë e cila të dhënat klinike i vazhdon edhe pas regjistrimit, por në Shqipëri kjo procedurë nuk njihet, si rrjedhojë nuk janë pranuar deri tani dosje të tilla për regjistrim. Pra prodhuesi nuk mund ta regjistrojë produktin drejtpërdrejtë." (fq 14)

Po ashtu në Kapitullin "Vlerësimi i efikasitetit të vaksinës" përcaktohet se:

"13. Përdorimi i vaksinave kundër COVID-19 do të fillojë vetëm pasi të jene të aprovuar nga autoritete strikte rregullatore." (fq 25)

Deri më sot nuk më është çituar me shkrim në këtë formular asnjë bazë ligjore regjistrimi e kësaj vaksine sipas përcaktimit që vetë Plani Kombëtar i Vaksinimit AntiCovid ka bërë. Ndaj dhe unë, përderisa nuk kam një referencë ligjore lejueshmërie të përdorimit të kësaj vaksine nuk mund të pranoj të vaksinohem. Në rast se paraqitet një referencë ligjore regjistrimi unë do të rishikoj qëndrimin tim në rast se përputhet edhe me Arsyen e mëposhtëme.

Arsyeja Ligjore nr2.

Kjo vaksinë nuk është "e miratuar" por "e autorizuar" "për përdorim emergjent".

Sipas të dhënave të publikuara nga institucionet ndërkombëtare por jo nga Qeveria Shqiptare kjo vaksinë nuk është i miratuar asnjë prodhuesi nga asnjë institucion ndërkombëtar në SHBA dhe BE si vaksinë e miratuar por vetëm si vaksinë e autorizuar "për përdorim emergjent". Përderisa kjo vaksinë nuk është e miratuar, ajo nuk mund të konsiderohet një vaksinë e ligjshme sipas përkufizimit ligjor të vaksinave.

Arsyeja Ligjore nr3.

Nuk kam info zyrtare për dobinë afatgjatë dhe pasojat afatgjata dhe afatshkurtëra të kësaj vaksine.

Sipas Qeverisë Shqiptare, Marëveshjet e Qeverisë Shqiptare me prodhuesit e vaksinave janë sekrete. Përderisa nuk ka transparencë për këtë çështje, unë nuk ndihem i/e sigurtë që ta pranoj.

Arsyeja Ligjore nr4.

Jam informuar nga media që prodhuesit nuk pranojnë të mbajnë përgjegjësi dhe as nuk dinë se çfarë pasojash afatgjata tek të vaksinuarit mund të ketë përdorimi i kësaj vaksine.

Sipas informacioneve të publikuara nga vetë ekspertët e Qeverisë, kjo vaksinë është një “terapi gjenike” pra fut informacion të ri gjenetik në qelizat e të vaksinuarit. Sipas publikimeve në media, rezulton se prodhuesit e vaksinave në marëveshjet me Qeverinë Shqiptare deklarojnë se nuk mbajnë përgjegjësi dhe nuk kanë dijeni për pasojat afatgjata për shkak të kohës së pamjaftueshme për testimet sipas protokolleve standarde të njohura shkencërisht dhe ligjërisht në botë.

Fragment nga Marëveshja Sekrete për Vaksinat midis Qeverisë Shqiptare dhe Pfizer e publikuar në mediat ndërkombëtare dhe e pakontestuar nga Qeveria Shqiptare (<http://ti-health.org/wp-content/uploads/2021/05/Albania-Pfizer.pdf>):

5.5. PRANIMI I BLERËSIT

“.. Blerësi më tej pranon që efektet afatgjata dhe efikasiteti i Vaksinës nuk dihen se mund të ketë efekte anësore të Vaksinës që nuk dihen aktualisht.. “

Arsyeja Ligjore nr5.

Konstatohet se nuk më jepet e drejta për kompensim financiar nga prodhuesit e vaksinave në rast të pasojave që mund të ketë vaksina, në kundërshtim me Kartën e të Drejtave të Pacientit.

Nisur nga mungesa e plotë e transparencës mbi Kontratën e Qeverisë Shqiptare me kompanitë prodhuese dhe referuar kontratës së Qeverisë Shqiptare me Kompaninë Pfizer të publikuar në mediat ndërkombëtare, unë konstatohet se nuk më garantohet e drejta për kompensim financiar nga ana e kompanive prodhuese të vaksinave, në kundërshtim me Konventat Ndërkombëtare të miratuara nga Qeveria Shqiptare, Legjislacionin Shqiptar dhe Kartën e të Drejtave të Pacientit.

Po Në kontratën e lidhur në mes Agjencisë Evropiane të Ilaçeve(EMA) të Bashkimit Evropian dhe kompanisë farmaceutike Astra Zeneca për furnizim të Bashkimit Evropian me vaksina të llojit Astra Zeneca shkruan:

“Kompania farmaceutike Astra Zeneca është e liruar nga çfarëdo përgjegjësie financiare, juridike dhe morale për këto efekte anësore nga vaksina e saj: për vdekjen, për të gjitha lëndimet fizike, psikike, emocionale, sëmundjet tjera të mundshme, mbetjen invalid si pasojë e vaksinës, si dhe të gjitha humbjet e paluajtshmërisë, punës, biznesit të individëve dhe të personave tjerë të lidhur me të dëmtuarin nga efektet

anësore të vaksinimit. Çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian paraprakisht heq dorë nga çdo pretendim ose akuzë kundër kompanisë farmaceutike Asta Zeneca lidhur me mundësin e josigurisë dhe joefikasitet të vaksinës së tyre”.

Arsyeja Ligjore (5)+1 (opsionale në rast se e kam kaluar infektimin me virusin Covid19)

PO JO

Unë e kam kaluar covidin dhe ai që e ka kaluar ka përgjigje imunitare më të lartë se i vaksinuari.

Sipas të gjithë statistikave, studimeve dhe raportimeve ndërkombëtare të të gjithë institucioneve të specializuara, si dhe pohimit të Dr. Ilir Alimehmeti, mjek i specializuar në nivel të lartë akademik, në fushat që kanë lidhje me Covid19, personat që e kanë kaluar covidin kanë imunitet më të lartë 6.7 herë më shumë dhe kohëzgjatje pa afat të përfunduar deri më sot që nga nisja e krizës covid19, se sa personat e vaksinuar. Deri më sot, shkenca nuk njeh asnjë rast që personat që kanë kaluar një infektim me një virus, të kenë nevojë të vaksinohen.

Arsyeja Ligjore (5)+2 (opsionale në rast se kam arsye religjioze që vaksinimi im me këtë vaksinë do të cënonte rëndë bindjet e mia fetare)

PO JO

Duke qenë se bindjet dhe besimi im fetar më ndalon mua të vaksinohem, unë e refuzoj vaksinimin për arsye besimi.

Arsye Ligjore Shtesë:

Jam i informuar se kjo vaksinë është “eksperimentale” dhe ndodhet në fazën tre të studimit deri në vitin 2023 ç’ka më bën mua të jem në rolin e subjektit eksperimental pra një lloj kavie njerëzore. Por Unë nuk jap në asnjë formë dhe me asnjë nënshkrim asnjë lloj pëlqim për të qënë subjekt i ndonjë eksperimentimi mjekësor apo shkencor.

1. Në dokumentacionin e vaksinës Pfizer-BioNTech referuar dokumentacionit të BE mbi subjektin e vaksinuar se: “Jam i njoftuar se vaksina akoma nuk është regjistruar, dhe se ka marr vetëm autorizim urgjent për përdorim, pasi që **është në fazën e tretë të hulumtimit klinik** dhe se efikasiteti dhe siguria e vaksinës tek do të vërtetohet. Kuptoj që pjesëmarrja në programin kombëtar të vaksinimit kundër COVID-19, nuk do të më mbrojë nga virusi COVID-19”.
2. Vaksinat kundër COVID-19 janë të natyrës emergjente, nuk janë të lejuara për përdorim të rregullt të tyre , pasi që akoma janë në fazën e tretë klinike të testimit gjer në vitin 2023, që është afati trevjeçar për testim, para se të vihen në përdorim të rregullt të tyre:” Vaksinat, nuk janë të lejuara nga agjencitë për lejimin e përdorimit të ilaqeve(sikurse që është FDA-ja amerikane apo EMA e Bashkësisë Evropiane), porse kanë leje për përdorim urgjent gjersa “zgjat gjendja

e jashtë zakonshme-emergency use”, që do të thotë se nuk janë kryer akoma studimet e nevojshme, e as që kanë marr leje për shpërndarje dhe shitje normale, porse **janë në fazën eksperimentale të implementimit mbi njerëzit**”.

3. Sipas Kodit të Nurnbergut: **“Pëlqimi** i subjektit njerëzor është absolutisht i nevojshëm. Kjo do të thotë që individ i cili kyçet në eksperiment duhet të ketë zotësinë juridike që të jep pëlqimin, kërkesa duhet të jetë e arsyetuar që individ të mund të shfrytëzojë mundësin e lirë të zgjedhjes së tij, pa intervenim të çfarëdo elementi të **forcës, mashtrimit, lajthitjes, imponimit, forcës së tepruar apo formës tjetër të kufizimit apo dhunës**, dhe do të do duhet të ketë dije të mjaftueshme dhe mirëkuptim të elementeve të lëndës në fjalë e cila do t’ia mundësonte atij sjelljen e vendimit të qartë dhe të kuptueshëm. Ky element i fundit kërkon që para pranimit dhe marrjes së vendimit pozitiv, subjektit eksperimental duhet t’i komunikohet natyra, afati dhe qëllimi i eksperimentit, metodat dhe pajisjet me të cilin do të kryhen, të gjitha shqetësimet dhe rreziqet të cilët mund të lajmërohen, efektet anësore për shëndetin e tij që mund të paraqiten gjatë eksperimentit”.

Pra sipas këtij Kodi me vlera por edhe përgjegjësi universale, konsiderohet Krim kundër Njerëzimit çdo eksperiment mbi njerëzit pa pëlqimin dhe me shtrëngimin, detyrimin dhe çdo formë tjetër shtrënguese siç po ndodh në disa vende dhe tani edhe në Shqipëri.

4. Sipas Rezolutës së Këshillit të Evropës nr. 2631 të datës 26 janar 2021 (ku Shqipëria është pjesë dhe ka marrë pjesë) e cila përveç tjerash përcakton:
- “7.3.1. të sigurojnë qytetarët që t’i informojnë se vaksinimi nuk është i detyrueshëm dhe askush nuk duhet të vihet nën presionin politik, shoqëror apo presion tjetër për t’u vaksinuar, në rast se ata nuk dëshirojnë të vaksinohen;”
 - “7.3.2. të sigurojnë që askush nuk duhet të diskriminohet sepse nuk është vaksinuar për shkak të rreziqeve të mundshme shëndetësore, apo që vet nuk dëshiron të vaksinohet”.

Si përfundim unë deklaroj me përgjegjësinë time të plotë se referuar:

a) Kartës së të Drejtave të Pacientit, dhe përkatësisht të drejtës për pëlqim:

Neni 4

“E Drejta per Pelqim

Cdo pacient ka Te drejten per akses ndaj Te gjithë informacionit qe i mundeson atij ose asaj pjesemarrje aktive ne vendimet e tij ose Te saj lidhur me shendetin; Ky informacion eshte nje kusht paraprak per cdo trajtim dhe procedure, perfshire dhe pjesemarrjen ne kerkim shkencor.”

b) Legjislacionit shqiptar për të drejtat e njeriut dhe konventave ndërkombëtare,

c) Kodit të Nurembergut (i miratuar në 1947)

d) Si dhe arsyeve të parashtruara më sipër,

- 1. Unë nuk ndihem i/e sigurtë që të përdor një barnë që nuk dihet se çfarë pasojash mund të prodhojë në trupin tim.**
- 2. Unë nuk jap asnjë pëlqim dhe nuk pranoj që të bëhem pjesë e ndonjë procedurë, programi, fushatë, apo forme e njohur apo e panjohur eksperimentimi direkt apo indirekt, studimi eksperimental apo trajtimi eksperimental, dhe duke iu referuar Kodit të Nurembergut çdo kush që përpiqet që me anë "forcës, mashtrimit, lajthitjes, imponimit, forcës së tepruar apo formës tjetër të kufizimit apo dhunës" të më nxisë, keqorientojë, manipulojë, shtrëngojë, detyrojë që të bëhem pjesë e një vaksine në fazë eksperimentale dhe studimi, po kryen një "krim kundër njerëzimit" sipas Kodit të Nurembergut.**

Kur të më ofrohet një vaksinë e ligjshme konform legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar, që jep siguri për pasojat e çastit dhe afatgjata, si dhe të ketë një procedurë transparente që të më garantojë verifikimin e çdo informacioni, unë do të rishikoj qëndrimin tim.

E kuptoj që mund të ndërroj mendim në çdo kohë dhe të pranoj vaksinimin, nëse do ketë ende gjendje të vaksinës ndaj COVID-19.

E kam lexuar dhe kuptoj plotësisht informacionin në këtë format refuzimi dhe po ashtu shpresoj që të mirëkuptimi dhe ju arsyet e mia të ligjshme.

Firma: _____

Data: _____